

University of Business and Technology in Kosovo
UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 10-2018

RESORT

Nuhi Lutfiu

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>

 Part of the Architecture Commons



Bartës Privat i Arsimit të Lartë
KOLEGJI UBT

Programi për Arkitekturë

RESORT
Shkalla Bachelor

Nuhi Lutfiu

Tetor/ 2018
Prishtinë



Bartës Privat i Arsimit të Lartë
KOLEGJI UBT

Programi për Arkitekturë

Punim Diplome
Viti akademik 2014-2017

Nuhi Lutfiu

RESORT

Mentori: Dr. Lulzim Beqiri

25/10/2018

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme për
Shkallën Bachelor

Abstrakt

Ndër faktorët kryesor për ndërtimin të këtij projekti është fluks i madh i turistëve anembar Kosovës të cilët me një kureshtje të madhe e vizitojnë çdo vjet në stinën e dimrit këtë bukuri të rallë natyrore që posedon Kosova. Po ashtu nuk është vetëm një vizitë e thjeshtë por kjo ndodh për shkak se me të vërtetë Brezovica është më e veçantë krahasim me vendet e tjera pasi që gjenden shumë pista të skijimit, lartësia e maleve, dendësia me lisa dhe klima perfekte gjatë sezonës së dimrit e bënë këtë pjesë një atraksion shumë të mirë turistik jo vetëm nga Kosova por edhe nga vendet e ndryshme të botës ku është përhapur emri Brezovic. Është një pikë ndalese për të gjithë skijatorët e botës tek kalojnë nga rajoni. Kështu që shihet qartë edhe mbipopullimi në këtë zonë dhe mbindertimi që dita ditës është duke u rritur me një hap shumë të madh kështu që duhet urgjent të bëhet një ndërhyrje që të mos vazhdojë të bëhet degradim i metutjeshëm kësaj pjesë që është pasurit me të mëdha të Republikës së Kosovës dhe të mos të lihet pas dorë nga qeveria. Unë mendoj se këtu domosdo duhet të ndërtohet një projekt i madh siç janë nëpër vende të ndryshme të botës resorte të skijimit ku në kuadër të resortit kuptohet përbehet me të gjitha kushtet e mundësuarat për turistët. Pra të bëhet një megaprojekt ku do të përmbushte të gjitha kushtet për të gjithë mysafirët dhe njëzërit në Brezovic të kënaqësi që mund t'ju shkojë ndermend.

Fjalët kyçe: resort, mysafir, dhoma, hapësira.

Mirënjohje

Falënderoj Zotin që më fali shëndet dhe në çdo problem, vështërsi, pengesë gjatë rrugës gjerë në këtë ditë sukseesi më hapi porta për ti kaluar ato.

Falënderoj familjen për mbështetjen, inkurajimin dhe ndihmën si financiare dhe atë morale gjatë periudhës së studimeve.

Unë shprehi mirënjohjen time të sinqertë për mentorin tim Prof.Dr.Lulzim Beqiri, për idenë e kësaj teme, gjithashtu vlerësoj lart mundin, kohën dhe udhëzimet gjatë periudhës së punimit të temës së diplomës.

Falënderoj të gjithë profesorët dhe asistentët e kolegjit UBT, për kontributin e tyre në përgaditjen time profesionale.

Përmbajtja

Abstrakt.....	3
Mirënjohje.....	4
Lista e figurave.....	5
1. Hyrja.....	6
1.0. Analiza e lokacionit.....	7
1.1. Analiza e funksionit.....	8
1.2. Analiza e konstruksionit.....	17
1.3. Analiza e materialit.....	18
1.4. Koncepti i resortit.....	20
Referencat.....	21

Grafike

2.1. Analizat 1:3500.....	1
2.2. Koncepti	2
2.3. Situacioni i gjere 1:500.....	3
2.4. Situacioni i ngushte 1:250.....	4
2.5. Baza e bodrumit 1:250.....	5
2.6. Baza e perdheses 1:250.....	6
2.7. Baza e perdheses sherbimet 1:250.....	7
2.8. Baza e perdheses spoertet 1:250.....	8
2.9. Baza e perdheses rekreacioni 1:250.....	9
2.10. Baza e katit 1:250.....	10
2.11. Baza e katit detal 1:250.....	11
2.12. Baza e kulmit 1:250.....	12
2.13. Prejret 1:250.....	13
2.14. Detalet	14
2.15. Fasadat 1:250.....	15
2.16. Perspektivat 3D.....	16
2.17. Perspektivat 3D.....	17
2.18. Perspektivat 3D.....	18
2.19. Perspektivat 3D.....	19
2.20. Perspektivat 3D.....	20
2.21. Villa.....	21

Lista e figurave

Figura 1. Relacioni i lokacionit me qytetet e Republikës së Kosovës dhe të Maqedonis	7
Figura 2. Qarkullimi dhe komunikacioni.....	8
Figura 3. Zhurma dhe ndriqimi.....	9
Figura 4. Qasjet dhe diellosja.....	10
Figura 5. Analiza urbane dhe hapësirat e gjelberuara.....	11
Figura 6. Baza e bodrumit.....	13
Figura 7. Baza e perdhësës.....	14
Figura 8. Baza e perdhësës shërbimet.....	15
Figura 9. Enterieri njësit në pjesën e shërbimeve.....	16
Figura 10. Baza e perdhësës sportet.....	17
Figura 11. Enterieri në pjesën e sporteve.....	18
Figura 12. Baza e perdhësës rekreacioni.....	19
Figura 13. Enterieri njësit në pjesën e rekreacionit.....	20
Figura 14. Baza e katit të parë.....	21
Figura 15. Baza e katit të parë dhe njësit e dhomave.....	22
Figura 16. Dhoma suit.....	24
Figura 17. Dhoma dopio.....	25
Figura 18. Dhoma familjare.....	26
Figura 19. Dhoma double.....	27
Figura 20. Enterieri i dhomave dhe funksionet.....	28
Figura 21. Prerjet.....	29
Figura 22. Perspektivat.....	30
Figura 23. Villa.....	31
Figura 24. Sistemi konstruktiv waffle.....	32
Figura 25. Sistemi konstruktiv cobiax.....	33
Figura 26. Sistemi konstruktiv diagrid.....	34
Figura 27. Koncepti.....	36

1.Hyrja

Fillimisht resorti nuk do te jete vetem qender skijimi pra kjo do te jete dicka me ndryshe e parealizuar deri me tani ne Kosove.Krysesisht jemi mesuar te shohim restaurante te medha hotele e objekte te ndryshme ku funksioni i tyre eshte i kufizuar me sherbimet qe i bejne.Keshtu qe me kete projekt te gjithë do te verejñ dallimin se cdo te thote motel,hote,resort.Pra ketu jam munduar qe te bie ne sy dallimi mes ketyre kategorive pasi qe ne jemi mesuar vetem ti emertojm gjerat sipas mendimit tone e jo sipas kategorive qe caktohen me rregullore te ndryshme dhe me ligj neper vende te tjera te botes.Siq eshte rasti i Brezovices ku mund te shihen shtepi individuale dy kateshe dhe emertohen me hotel por funksioni nuk i pershtatet aspak nje hoteli e as menyra e sherbimit nuk i plotson kushtet qe te emertohet me hotel.Keshtu qe me kete resort do perfshihen te gjitha funksionet qe mund te kryej nje resort edhe pse do te duket nje mega projekt por kjo eshte nje realitet se siq duhet te jete nje resort pasi qe ketu nuk e kemi fjalen per objekte siq jemi mesaur te shohim neper vendin ton.

Kushtet qe do ti plotsoj ky projekt eshte analizuar detalisht ne te gjithë sferat e mundshme ketu nuk do te jete vetem nje akomodim ku do behet si lloj biznesi per perfitim parash por do behet nje ndertim i mirefillt per te gjithë gjeneratat ku do mund te vizitojn nga mosha 7-70 gjithë gjenerata do kene mundesi te vizitojn kete vend dhe te plotsoj kushtet e te gjithëve duke i akomoduar ne menyren me te mire siq psh:

Per gjeneratat e vogla per femije do kete kopsht zoologjik me kafshet te cilat jetojn neper viset e teritorit te Kosoves kryesisht ne malet e Sharrit dhe do behet ekspozimi i kafsheve te ndryshme duke ndikuar dhe i mesaur femijet me bukurit natyrore qe i posedon Brezovica.Pastaj do te argetohen me kinema ku do kene mundesin te shikojn filma apo dokumentar te ndryshme gjate diteve te ndryshme do kene edhe sallën e konferencave ku do te perdoret si teater,do ta ken edhe librarin ku do mund te lexojn libra te ndryshme revista nga botimet e fundit ku do te mundesohet edhe per gjenerata te ndryshme.

Kurse per gjeneratat e reja dhe klubet te ndryshme te sportistëve do te kete mundesi te shumta te trajnimit ku do ken salla te ndryshme siq jane permandur me lart po ashtu edhe nga pjesa e argetimit do te kete edhe poligon per gjuajte ku do mundesonte gjuetaret te trajnohen apo te trajnojn gjeneratat e reja dhe sportistet te cilat do te marrin pjese na gara te ndryshme neper bote.

Dhe me ne fund per gjenerata e vjetra apo te moshuara do te kete pishina,sauna,jakuzi,masazh,kujdesi dhe klinika te ndryshme pra nje lloje banje me mjek te specializuar ku do te jene ne detyre per tu kujdesur per te moshuarit.Poashtu edhe uji do te mbartet nga burimet e ftohta te Brezovices dhe po ashtu nga liqeni i cili gjendet ne majte te malit i quajtur Gjoli.

1.0 Analiza e lokacionit

-Lokacioni i resortit eshte ne Brezovic ne pjesen ku turizmi e arrin fluksin me te madh gjate sezonet se dimrit poashtu kjo ishte arsyeja e pare e zgjedhjes te ketij lokacioni. Dhe perben nje pozite shume te mire gjeografike.




Figura 1. Relacioni i lokacionit me qytetet e Republikës së Kosovës dhe të Maqedonisë.

-Rrethina urbane eshte kryesisht nga hotelet te vogla, kafeteri dhe shtepi te vogla private te cilat shumica jane pa leje ndertimi duke e degraduar natyren e bukur te Brezovices, e gjithë kjo pas fluksit te madh te turistëve anembar Kosovës te cilet e vizitojn kete pjese. Keshtu qe ideja ishte nje projekt me i mire i mundshem per te krijuar nje komoditet sa me te madh dhe akomodimin e nje numri aq te madh turistesh.




Figura 2. Qarkullimi dhe komunikacioni.

-Qarkullimi për automjete bëhet me anë të rrugës së cilës është asfaltuar deri në fund të hotelit të ekzistues që nga koha ishjugosllave Molika. Për qarkullimi bëhet lirshëm deri tek brendësia e lokacionit, por i vetmi problem është që gjatë sezonit të verës dhe sezonave të tjera me tërheqjen apo shkërrjen e deborës mund të dallohet se sa e demtuar është asfalti pasi që krijohen gropa të mëdha në asfalt kurse në dimër këto demtime nuk dallohen pasi që ka reshje të mëdha të borës dhe klima e fortë e Brezovices demton rrugët e asfaltuara por e gjithë kjo nga mos kujdesi i qeverisë së Republikës së Kosovës dhe komunës së cilës funksionon në këtë pjesë shihet se është anashkaluar një vend kaq i rëndësishëm për turizëm. Por duke i falenderuar qytetarët e Kosovës perseri nuk largohen dhe e vizitojnë këtë vend çdo ditë e me shumë.




Figura 3. Zhurma dhe ndriqimi.

-Gjate analizave te lokacionit pas shume fotove te bera dhe matjeve te ndryshme inspirim me i madh ishte tek teleferiket te cilet do hynin ne brendesi te parces se resortit.Edhe pse ato krijonin zhurme gjate dites pasi punojne gjate tere dites me orar te plot por nuk duhet te harrojm se ketu jemi tek nje resort ku nder cilesit te para e ka skijimin dhe argetimi me i madh ketu eshte skijimi pasi qe eshte i njohur per stazat e skijimi nder me te mirat ne rajon.Ndriqimi elektrik eshte instaluar mir deri tek brendesia e lokacionit pasi qe eshte hoteli i vjeter egzistues qe funksionon ende qe nga koha ishjugosllave.




Figura 4. Qasjet dhe diellosja.

-Qasjet ne lokacion siq eshte permendur me larte veq se egzistojne rruget te asfaltuara por shume te demtuara te lena pas dore nga qeveria dhe nga komuna te cilat funksionojn atje. Kishte edhe rruge dytesore jo te asfaltuara por te krijuara nga traktoret dhe gjipat te medha ku benin transportimin e ndryshme te kafsheve dhe te ushqimeve nga fshtrat e aferta qe banonin njerezit aty. Diellosja eshte kryesisht nga pjesa ku eshte pjerrtesia me e madhe lokacionit nuk pershtatet edhe aq shume me lokacionin keshtu qe gjat projektimit te resortit ishte nje nder kushtet me te rendesishme qe duhet te shikohej dhe te analizohej.




Figura 5. Analiza urbane dhe hapesirat e gjelberuara.

-Gjate analizes urbane kur shikohet tek rrethina shihet se ka shum objekte dhe jane teper te vogla kafeteri te ndryshme te njohura te kosoves hotele te vogla dhe shtepi private te cilat leshohen si motele pra eshte nje miks shume i madhe e sherbimeve te ofruara nga pronaret aty qe jane,ku nuk dihet funksioni i plot i ketyre objekteve pasi qe nuk i plotsojne as nje perqindje te vogel te sherbimeve qe i ofrojn.Me projektin e ri besoj qe do kuptohet me se miri fjala resort dhe do vetdijesohen se cfare eshte motel,hote dhe resort.

1.1 Analiza e funksionit

-Planimetria e Resortit është ndarë në tre pjesë të ndryshme ku do të ketë shumë funksione pasi që nuk jemi larguar aspak komoditetit dhe shërbimit sa me cilësor për klientet. Funksioni që do të kryejë ky objekt do të jetë multifunksion ku do të ketë një numër të shumfishtë të funksioneve pasi që vetë fjalë resort tregon se behet fjalë për një objekt shumë të madh krahasim me objektet e tjera me të vogla dhe mund të dallohet që me fjalën resort e kuptojmë një shumëllojshmëri të funksioneve që do të supozojmë mysafireve të vetë. Që nga hyrja do të behet akomodimi me bodrumin e resortit për mysafiret të cilët do të vijne me mjete të tyre motorike dhe të parkojnë aty sipas rezervimit dhe numrit të hotelit që e kanë, kurse për mysafiret të cilët do të vijin me transporte të ndryshme publike ose organizata të ndryshme do të ketë një strehim me dalje të konzolës në hyrje të objektit dhe menjëherë pritja deri në një numër të madh të mysafireve të cilët mund të akomodohen dhe të presin për të vendosur nëpër dhomat e tyre. Nëdergjatë me të rëndësishme është afërsia e teleferikëve të cilat nuk janë larguar nga parcella dhe posaqirë për shkak të tyre edhe forma e objektit është dizajnuar në atë mënyrë që të kenë ndërhyrje deri në thellesitë të parcelës në afërsi të objektit ku do të mundesojë për mysafiret e hotelit një afërsi pa pasur nevojë të udhetojnë gjatë teleferikut pa asnjë lloj mjeti por vetëm mund të dalin nga daljet e katit të hotelit dhe të bashkangjiten teleferikut.

A) Baza e Bodrumit

-Bodrumi është i përbërë nga kthina teknike, ashensore, oborr te brendshem, parkingje per vetura dhe parkingje per mjete te tjera motorike .Etazhitei shkon deri 8 kate me lartesi 2.80cm dhe nje siperfaqe totale prej 5720m² etazha e pare kurse etazhet me te larta siperfaqja zvogelohet duke u ngritur pasi qe eshte kaskad ku e gjitha eshte nentoke dhe krijimi i parkingut sipas lokacionit eshte me e mira pasi qe nuk duhet germimi i tokes ne thellesi por vetem siperfaqesor.




Figura 6. Baza e bodrumit.

B) Baza e Përdhesës

-Baza e perdheses eshte hapesir e ndare ne tre pjese ku sipas mendimit tim jam munduar ti organizoj te gjitha sipas funksionit qe do te kryejne keto hapesira te medha. Dhe i vetmi qellim i ndarjes se ketyre hapesirave nuk eshte funksioni por eshte edhe pjesa egzistuese te teleferikeve ku deshira ime ishte qe ato te nderhyjne ne afersi te hotelit dhe ne brendesi te lokacionit pra nuk eshte rastesi ndarja e hotelit ne tresh. Keshtu qe une i kam ndare ne tri njesi ku i kam emertuar sherbimet, rekreacioni dhe sportet. Te gjitha te ndara nga 5000m² ne total perdhesa perfshin nje siperfaqe prej 15.000m².




Figura 7. Baza e përdhesës.




Figura 8. Baza e përdhësës shërbimet.

-Pjesen e sherbimeve e perbejne:hyrja,ashensoret,bagazhi,pritja,recepsioni,garderoba,zyret,wc,fontana,bari,lobi,restauranti,salla e konferencave,dhoma e mbledhjeve,libraria/biblioteka,kinemaja,klubi nates,salla eventeve,orquestra,dhoma e pergadtijes.Bagazhi per mysafiret e ri 30m² ku sigurohet koferet dhe qantat deri sa te behet akomodimi i mysafireve.Pritja me 70 persona duke krijuar rehati gjat pritjes dhe te marr informata nga recepsioni ku ketu perbehet edhe garderoba dhe wc per mysafiret deri sa te kalojne kohen mundesohet edhe servimi me pije nga bari.Bari perbehet nga 23 uleseve ku eshte ne kuader te lobit ku edhe ne lobi eshte nje hapesine per mysafiret te hotelit ku mundesohet nje akomodim deri ne 180 ulse.Restauranti perbehet nga 28 tavolina me dy kariga,16 tavolina me 4 kariga,16 tavolina me 6 kariga,ulse kauqe tek muret me shank deri 12 persona dhe 4 tavolina grupore me nga 5/10 ulse.Ne total eshte nje hapesine ku akomodon 270 persona dhe nje siperfaqe 630m².Salla e konferencave akomodon deri 220 persona me spierfaqe 380m².Libraria eshte me 32 ulse dhe 370m².Kinemaja me 140 ulse dhe 460m².Klubi nates eshte per 200 persona me 460m².Salla e eventeve eshte me 320 ulse dhe nje siperfaqe me 1000m².




Figura 9. Enterieri njesit ne pjesen e sherbimeve.




Figura 10. Baza e përdhësës sportet.

-Pjesen e sporteve e perbejne:hyrja,ashensoret,informata,kujdesi,salla e tenisit,wc,garderoba,banjo,bowlingu,bari,patinazhi,dhomat e mbledhjeve,zyret,salla e basketit,pishina olimpike.Te gjitha jane me hapesira adekuate dhe kthina me standarte qe mundeson organizim, akomodim dhe rekreim sikurse tek nje salle e sporteve duke iu mundesuar te gjitha kushtet.Poashtu edhe numer te caktuar te shikuesve ku ne kete pjese do vijne per sportistet tone te Kosoves dhe do bejne pergaditjet e tyre per olimpiada dhe do perdoret si qender e pergaditjes olimpike dhe mund te shfrytzeohet nga turistet apo mysafiret e hotelit.




Figura 11. Enterieri njesit ne pjesen e sporteve.




Figura 12. Baza e përdhësës rekreacioni.

-Pjesen e rekreacionit e perbejne:hyrja,ashensoret,pritja,dyqanet,fitnesi,wc,garderoba,banjo,sauna,kujdesi,jakuzi,pishina,poligoni,kasino,kopshti zoologjik,qendra tregtare,butikat.Tek pritja ketu eshte e caktuar nje numer me i vogel deri me 18 persona dhe vazhdon me 12 dyqane te vogla luksoze per veshmbathje dhe te gjitha gjerat e nevojshme per lokacionin te cilat nuk perdoren vetem nga mysafiret e hotelit por edhe nga rrethina e Brezovices.Saunat,kujdesi,jakuzi,masazha te gjitha behet ne kuader ne lidhje te ketyre hapesiave nga fitnesi deri tek pishina.Pishina perbhet nga 56 ulese ku eshte i ndar ne dy pjes per meshkuj dhe femra dhe eshte i perber nga ujrat e burimeve te Brezovices.Kasino deri 250 persona.Poligoni me 6 rende te gjuajtes ne te njeten kohe duke mundesuar nje argetim te mir per gjuetaret.Kopshti zoologjik permban lloje te ndryshme te kafsheve te cilat jetojne ne malet e Sharrit me 22 kafaze dhe kafshet me specifikate do te kene hapesire ne kopshtin e ketij resorti dhe do mundesoj te shfaq ato tek vizitoret.Qendra tregtare eshte njera nder hapesirat kryesore qe i duhej kesaj zone turistike pasi qe transporti behej nga rrethina nuk ka asnje market apo gje te tille ku mund te blehet ushqimi apo produkte te ndryshme ushqimore.




Figura 13. Enterieri njesit ne pjesen e rekreacionit.

C) Baza e katit të parë

-Baza e katit të parë është i përbërë nga disa njësi të dhomave të ndryshme. Kati i parë përmban: shkallet, ashensoret, dhe dhomat me njësi të ndryshme po ashtu është me galeri hyrese ku krijon një pamje perfekte në momentin që mysafiri del nga dhoma. Njësitë e dhomave janë: dhoma suit, dhoma dopio, dhoma familjare, dhoma standarte, dhoma double.




Figura 14. Baza e katit të parë.




Figura 15. Baza e katit të parë dhe njesit e dhomave.

Dhoma suit

-Kjo njësi dhome përmban: qendrimin ditor,kuzhinen,tryezarin,kendin e kaminit,nje dhome per mysafir,banjo,garderobe,dhoma suit.Kjo dhome eshte me nje siperfaqe 130m².



Figura 16. Dhoma Suit.

Dhoma dopio

-Kjo njësi dhome përmban: garderoben,kendin e qendrimit,banjon,dhe fjetjen.Me nje siperfaqe 36m².



Figura 17. Dhoma Doppio.

Dhoma familjare

-Dhoma familjare eshte nje dhome sikur nje garsonier nje banes e vogel ku perfshin te gjitha funksionet per nje familje dhe perben:garderoben,qendrimin ditor,wc,banjo,dhomen e fjetjes dhe kendin per qendrim.Me nje sipërfaqe pre 55m².



Figura 18. Dhoma familjare.

Dhoma double

-Kjo njësi dhome përmban: garderoben,fjetjen,qendrimin per kamin,dhe banjon.Me nje siperfaqe 32m² vetem nje pjese kurse pasi qe te bashkohet me terheqjen e paravanit behet 64m².




Figura 19. Dhoma double.

Enterieri i dhomave

-Enterieri i dhomave eshte kryesisht me mure nga druri per nje dukje me organike dhe me te ngrohte duke u pershtatur lokacionit malor. Materiale te qendrushme te lekures dhe parket poashtu eshte perdorur edhe ngjyra gold duke e shprehur luksin qe e krijon ky resort.



Figura 20. Enterieri i dhomave dhe funksionet.

D) Prerjet

-Tek prerja e objektit me se miri mund te dallohet pjerrtesisa e terrenit ku kjo pjese eshte pjesa me e pjerret e lokacionit tek pjesa e sallave sportive e deri tek pishina olimprike,duhet te shkohej ne menyre te shkallezuar deri tek nievli me i lart,kurse parkingjet vendosen ne toke pa pasur nevoj per germime ne thellesi te tokes por vetem mbi sipërfaqen e tokes,dhe mbi keto hapësira te medha nje etazhitet mjaft i madh qe duhet te qendroj gjithe ato dhoma.




Figura 21. Prerjet.

E) Perspektivat

-Ketu jane ekspozuara perspektivat e ndryshme te resortit kyresisht rruga deri tek hoteli teleferiku afer hoteli duke mos e larguar nga lokacioni, fasada e objektit me detalet e roletave te hekurta dhe hyrja e hotelit.




Figura 22. Perspektivat.

F) Villa

-Villat do të jehen në kuader të hotelit por në shpërndarë në tërë lokacionin e Brezovices. Keto villa do të jehen të llojit Cabana të cilat do të vendosen në hapësirat ku do të mundësohet një vizurë sa më të mirë të këtyre villave pra duhet të analizohet dhe shikohen ku do mund të krijojnë vizurat më të mira dhe të vendosen këto. Poashtu pasi që do të jehen në kuader të resortit e gjithë shërbimet do të bëhen nga hoteli si ushqimi, ngrohja, mirëmbajtja, qarkullimi, sigurimi etj. Këtu do të jehet luksi më i madh se sa në resort pasi që do të jehen të veçuara dhe të qeta nga pjesa tjetër e resortit pasi që do të kenë mundësinë të shfrytëzimit të gjithë vilës poashtu mbarjta në këto villa do të bëhet me transporte të ndryshme në kuader të resortit. Keto vila do të kenë funksion të thjeshtë dhe komode për mysafiret jam munduar të kem ndarje sa më pak të mureve pra sa më pak pengesa të vizurave dhe ndriqim natyral i mirë në të gjithë hapësirat e mundshme, në qendër të objektit do të ketë banjot ku nuk do të ketë ndriqim natyral, do të jehet sikur një bosht për objektin ku do të mbajë shkallet dhe dhomen e fjetjes me garderoben që qëndron mbi të, hapjet, ngjyrat, materializimi, e gjithë janë të analizuar në mënyrë të përshtatshme.

Është i ndarë në qëndrimin ditor, hapësirën për kamin, mini kuzhinën, banjot, shkallet të cilat të dergojnë tek dhoma e fjetjes e cila nuk ka mure por është me galeri të hapur pa asnjë lloj pengese të vizurave ku dhoma e fjetjes posedon edhe garderoben e vet.

Është edhe terasa e cila përdoret shumë në Brezovice shumica e restuarnteve janë të stermbushura me terasa të plota me klientet e tyre pasi që klima gjatë sezonit të dimrit në përvallë shumicën e rasteve është shumë e mirë.




Figura 23. Villa.

Bartës privat i Arsimit të Lartë, Kolegji UBT, Programi për arkitekturë
Punim Diplome: Studenti: Nuhi Lutfiu, Dr. Lulzim Beqiri

1.2 Analiza e Kontruksioneve

-Konstruksioni i ndërtesës është analizaur ne detaje pasi qe te gjithë kete ngarkes te dhoamve te hotelit duhej te qendrojne mbi hapsirat e medha siq jane sallat e ndryshme te sporteve,qendra tregtare,salla e eventeve,pishia olimpike te gjithë keto njesi duhet te ken hapësira te medha te pastra pa shtylla.Keshtu qe duhej te behej nje analiz rreth sistemeve te ndryshme konstruktive te cilat do te mundesonin nje hapësire te tille me nje ngarkes kaq te madhe mbi to.

-*Konstruksioni Waffle* :eshte sistem i konstruksionit krijohet me ane te kallepave te katrorit PVC te cilat vendosen mbi kallepet e drurit kurse mbi to vendoset armatura rrjet ne dy drejtime dhe midis ketyre plastikave kalojn traret e ngushta dhe te gjata te cilat mundesojne lidhjen me forme rrjete.Pas kesaj behet betonimi ne fund dhe plastika largohet dhe mbesin hapësirat e krijuara te shprazta.Pllaka eshte e holle 10-12cm kurse traret jane 40-60 cm dhe eshte sistem shum i mire per krijimin e hapësirave pa shtylla kryesisht per daljet ne konzola.




Figura 24. Sistemi konstruktiv Waffle.

-*Konstruksioni Cobiax*: është sistemi i quajtur paranderje dhe nje sistem konstruktiv e cila perdoret kryesisht tek urat ku eliminon nje numer te madh shtyllash dhe krijon hapësira te pastra ne shtylla mbi 20m. Behet kallepimi i pllakes pastaj armimi dy anesor dhe vendosen topthat qe luajn rol ne lehtesimin e pllakes dhe midis ketyre kalojn kabllot qe ngrhen me tension dhe kjo quhet paranderje. Dhe ky është konstruksioni i cili është perdorur tek resorti pasi qe ishte me i miri sipas analizave te bera dhe me i pershtatshem per lokacionin ku gjendet objekti.




Figura 25. Sistemi konstruktiv Cobiax Post-Tension.

-*Konstruksioni Diagrid*: është sistem që përdoret për ndërtesa të larta që është një sistem shumë i fuqishëm dhe qëndrueshëm ndaj ndikimeve të ndryshme natyrore të ngarkesave të cilat shpërndahen në mënyrë aksiale sipas modulit. Është konstruksion i jashtëm i cili është si estetik për edhe hapësira të mëdha për ndriqim natyral, pra mund të bëhen hapje të mëdha në fasadë duke mos e penguar vizurat pasi që edhe objekti ka nevojë për vizura pa pengesa të shtyllave apo hapje të kufizuara. Këndi sa më i vogël stabilitet aq më të madh në ndërtesa ku e ngurteson atë në mënyrë më të mirë pasi që është një sistem modular dhe me konstruksion të fortë. Këndi 35-70 poashtu bazohet në etazhitet dhe lartësinë e objektit. Përafërsisht 20% më e vogël sesa tek sistemet e tjera standarte konstruktive të cilat përdoren në objektet të ndryshme pasi që nuk ka nevojë për shtylla, pllakë, mure mbajtëse etj., por i vetmi gjë që duhet janë trajektet të cilat i lidhin nyjet dhe qëndron në mënyrë të pavarur.




Figura 26. Sistemi konstruktiv Diagrid.

1.3 Analiza e materialit ndërtimor

-Materialet ndërtimore që janë përdorur janë, tek muret e mbrendshme është përdorur: bllok gjysmë giter 19cm, pambuk mineral termoizolus,dhe mveshje druri. Tek muret e jashtme është përdorur: Mbrotja nga era, izolimi termik,bllok gjysmë giter 19cm, llaci, suvatimi,dhe mveshje druri.Tek pllaka e themelit eshte perdorur disa shtresa izoluese siq eshte membrane bituminoze,hidroizolimi etj. Tek pjesa hyres eshte dalur konzol duke krijuar nje streh te madhe ndaj ndikimieve atmosferike. Në dhoma janë përdorur dyer te zeza duke u dalluar per dalje me te leht dhe te verehet me shpejt pasi qe muret jan nga druri.Shkallët e evakuimit është përdorur cdo 20m largesi dhe jane perdorur ashensoret qe te dergojne ne nivelin e katit

1. Materialet të cilat janë përdorur në fasadë, janë përdorur për një arsyë.

-*Druri*: Eshte material i ngrohte dhe eshte kontekstualuar me ambientin qe e rrethon pra pishat e shumta

-*Roletat e hekurta*: Jane ne menyre elektronike po ashtu ne rastet urgjente perdoren duke e mbuluar te gjithë dritaret hapjet e mundshme te dhomes de dhe perdoren ne raste te ortekut frymes apo mvaret nga deshira e klientit ne rase do qe ti perdor dhe mos ti hap apo ti le te hapura gjat gjithë kohes.Por nder konceptet kryesore eshte perdorimi i tyre ne raste emergjente ndaj fatkeqsive natyrore duke u perballur me natyren e eger te Brezovices.

1.4 Koncepti resortit dhe villes

-Koncepti i resortit dhe i villave ishte nga vet lokacioni dhe bukurit natyrore te Brezovices ku koncepti nuk ishte ndonje nderlidhje te menduarit se cfar duhet te behet si concept por koncepti ishte vet inspirimi i gjithë projektimit te resortit dhe te vilave ku mund te dallohet me se miri nga figurat e meposhtme.




Figura 27. Koncepti.

Referencat

1. D+A Desino+Arquitectura,Hoteles Y Restaurantes,40,September/October 2014
2. Bousmaha Baiche, Nicholas Walliman Eds. “**Ernst and Peter Neufert: Architect's Data**” 3rd ed. Blackwell Publishing, 2002
3. Adler, David “**METRIC HANDBOOK: Planning and Design Data**” Architectural Press, 1999
4. Boubekri, Mohamed “**Daylighting, Architecture and Health: Building Design Strategies**” Elsevier Ltd., Oxford, 2008
- 5.
6. <https://www.discover-alps.club/>
7. Author: Yeal Xie
Print version (Hardcover) – 2011
ISBN 9787538166934
Published by Liaoning Science & Technology Publishing House
Shenyang, Liaoning, China
- 8.Resort Destinations
Evolution, Management and Development**
Bruce Prideaux
*Professor of Marketing and Tourism Management
James Cook University, Australia*
- 9.Resorts of 10 Leading Brands,edited by Mandy Li,translated by Weinan Dai,Design Media Publishing Limited
- 10.Copyright©2011 Liaoning Science & Technology Publishing House
License agreement: www.architecturalbookstore.com/auxpage_license
Unauthorized copying prohibited.
11. **ECO-RESORTS: PLANNING
AND DESIGN FOR THE
TROPICS**
Zbigniew Bromberek
AMSTERDAM • BOSTON • HEIDELBERG • LONDON • NEW YORK • OXFORD
PARIS • SAN DIEGO • SAN FRANCISCO • SYDNEY • TOKYO
Architectural Press is an imprint of Elsevier